



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 6.3.2024

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

**MIRATIMIN E FLETËS TIP PËR MBLEDHJEN E NËNSHKRIMEVE PËR NISMËN
LIGJVËNËSE TË ZGJEDHËSVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, PËR
PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË
LIGJIN NR. 10019, DATË 29.12.2008 “KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 6, nenit 10 dhe nenit 13, pika 1, të ligjit nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”,

VËREJ:

Komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse të zgjedhësve, i përbërë nga: z. Kristaq Kume, përfaqësues i Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, zj. Olta Qejvani, përfaqësues i Qendrës për Progres Rinor – Kukës, z. Linert Lirëza, përfaqësues i Shoqatës “Hapa të lehtë” – Shkodër, zj. Mirjam Reçi, përfaqësues i Qendrës për Zhvillim të Shoqërisë Civile – Durrës, kanë paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën nr. 724 Prot., datë 13.03.2024, për pajisje me fletë tip për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Bashkëlidhur kërkesës, komiteti përfaqësues ka depozituar:

- Projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”;
- Relacionin shpjegues të projektligjit;
- Kopje të kartave të identitetit të komitetit përfaqësues të nismës.

Projektligji që do t’i propozohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, sipas kërkesës së komitetit përfaqësues, ka për qëllim të përmirësojë funksionimin e demokracisë përfaqësuese, me objektiv ritjen e cilësive në qeverisjen e vendit. Projektligji synon:

- a) Krijimin e hapësirës efektive ligjore për përfaqësimin proporcional në Kuvendin e Shqipërisë, të zgjedhësve të të gjithë rajoneve të Shqipërisë.
- b) Rregullimin e kushteve për ushtrimin e të drejtës së zgjedhësve për të zgjedhur në mënyrë direkte, përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Shqipërisë.

Data: 6.3.2024 Nr: 28
Ora: 12:00



“Për miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”

Në zbatim të nenit 10, të ligjit nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të miratojë me vendim brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës, modelin e fletës tip të mbledhjes së nënshkrimeve dhe ta publikojë atë në faqen zyrtare të KQZ-së, në një format të shkarkueshëm. Fleta tip e mbledhjes së nënshkrimeve, në njërën anë duhet të përmbajë informacion mbi nismën ligjvënëse që do t’i propozohet Kuvendit, qëllimin dhe një shpjegim të përmbledhur të saj si dhe të dhëna për përfaqësinë/komitetin përfaqësues të nismës. Në anën tjetër duhet të përmbajë: numrin rendor, gjenealitet e zgjedhësit që mbështet nismën, vendin dhe datën e lindjes, numrin e kartës së identitetit apo pasaportës së zgjedhësit, kolonën për nënshkrimet e zgjedhësve si dhe hapësirën përkatëse për emrin dhe mbiemrin e anëtarëve të grupit të mbledhjes së nënshkrimeve.

Referuar nenit 13, pika 1, të ligjit nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës me shkrim të përfaqësisë/komitetit përfaqësues të nismës për pajisjen me fletët tip për mbledhjen e nënshkrimeve, përcakton me vendim, sipas propozimit të përfaqësisë/komitetit përfaqësues, periudhën kohore gjatë të cilës zhvillohet procesi i mbledhjes së nënshkrimeve, në vendet publike dhe private, si dhe nënshkrimeve elektronike.

Kërkesa e komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse përmban informacion mbi nismën ligjvënëse që do t’i propozohet Kuvendit, qëllimin dhe shpjegimin në mënyrë të përmbledhur të saj si dhe të dhënat e komitetit përfaqësues të nismës. Nga kërkesa e depozituar pranë KQZ-së, periudha kohore e propozuar nga komiteti përfaqësues i nismës për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve, është 3 (tre) muaj nga data e hyrjes në fuqi të vendimit.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 6, nenit 10 dhe nenit 13, pika 1, të ligjit nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S:

1. Miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe publikimin e saj në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Procedura për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve të realizohet brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: .3.2024 Nr:
Ora:



“Për miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

FLETË TIP PËR MBLEDHJEN E NËNSHKRIMEVE PËR PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10019, DATË 29.12.2008 “KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR”

Nr.	Emri, Atësia, Mbiemri	Datëlindja (data, muaji, viti)	Vendlindja	Nr. i kartës së identitetit ose pasaportës	Nr. Tel	Nënshkrimi i zgjedhësit
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						
14						
15						
16						
17						
18						
19						
20						
21						
22						
23						
24						
25						

Grupi i mbledhjes së nënshkrimeve

(emër, mbiemër, firma)

Mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”, Komiteti Përfaqësues i nismës ligjvënëse të zgjedhësve, i përbërë nga:

- Z. Kristaq Kume, përfaqësues i Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve,
- Zj. Olta Qejvani, përfaqësues i Qendrës për Progres Rinor – Kukës,
- Z. Linert Lirëza, përfaqësues i Shoqatës “Hapa të lehtë” – Shkodër,
- Zj. Mirjam Reçi, përfaqësues i Qendrës për Zhvillim të Shoqërisë Civile – Durrës,

kërkon t’i propozohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, i cili ka për qëllim të përmirësojë funksionimin e demokracisë përfaqësuese, me objektiv rritjen e cilësive në qeverisjen e vendit.

Projektligji synon:

- a) Krijimin e hapësirës efektive ligjore për përfaqësimin proporcional në Kuvendin e Shqipërisë, të zgjedhësve të të gjithë rajoneve të Shqipërisë.
- b) Rregullimin e kushteve për ushtrimin e të drejtës së zgjedhësve për të zgjedhur në mënyrë direkte, përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Shqipërisë.